



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 340/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Xhafer Plaqiqi, kandidat për deputet nga koalicioni Nisma-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Qendrave të Votimit Nr.0310E, QV Nr.0302E, dhe QV Nr.1304, për shkak të mungesës së votave gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa A.nr 340/2019 e datës 07.10.2019, e paraqitur nga Xhafer Plaqiqi kandidat për deputet nga radhët e koalicionit Nisma-AKR-PD, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 07.10.2019, ka pranuar një ankesë Anr.340/2019 nga Xhafer Plaqiqi kandidat për deputet nga radhët e koalicionit Nisma-AKR-PD, në të cilën theksohet se gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrat e Votimit dhe Vendvotimet si: Shkolla Bajram Curri Nekoc Q.V Nr.0310E, VV. Nr.0310e-1R, 0310e-2R, 0310e-3D, Shkolla Xheladin Gashi në Komoran, Drenas QV Nr.0302E, VV Nr.0302e-01R, 0302e-02R, 0302e-03R, 0302e-04R, 0302e-05D, SHFMU Shalë Lipjan QV Nr.1304, VV Nr.1304e/01R, 1304e/02R, 1304e/03R, ku thekson se votuesit me mbiemër Gashi, Plaqiqi, Sylaj, Zekaj, Ibriqi, Mulaku, Nuhaj, Canolli, Korpuzi, Ademi dhe Shamolli, të cilët janë farefisi im dhe njëkohësisht kanë qenë pjesë e shtabit tim zgjedhor, kanë votuar për mua, ndërsa këto vota nuk janë evidentuar në formularin për kandidat, përkatësisht si vota të numëruara për mua.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në Qendrat e Votimit dhe në Vendvotimet Q.V Nr.0310E, VV. Nr.0310e-1R, 0310e-2R, 0310e-3D, Shkolla Xheladin Gashi në Komoran, Drenas QV Nr.0302E, VV Nr.0302e-01R, 0302e-02R, 0302e-03R, 0302e-04R, 0302e-05D, SHFMU Shalë Lipjan QV Nr.1304, VV Nr.1304e/01R, 1304e/02R, 1304e/03R, për faktin se shkeljet që ndërlihen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendim përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Xhafer Plakiqit nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 340/2019 më datën 10.10.2019**

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.